

**RISHIKIM I  
STRATEGJISË SË ENERGJISË SË REPUBLIKËS  
SË KOSOVËS 2017-2026**

**Prishtinë, 2017**

## **Përmbajtja**

Hyrje .....	2
1. Gjetjet e Përgjithshme.....	2
2. Objektivat joproportionale .....	5
3. Strategji e Energjisë pa planifikuar naftën.....	8
4. Gjetjet tjera .....	9
Përfundime.....	9

## Hyrje

Draftimi i Strategjisë së Energjisë për periudhën dhjetëvjeçare 2017-2026 është një zhvillim i duhur në sferën e politikave publike në Kosovë. Lënia e sektorit të energjisë pa një dokument strategjik unifikues gjatë viteve të fundit ka dëmtuar zhvillimin e politikave publike në sektorin e energjisë. Së këtejmi, drafti aktual i strategjisë është një e arritur në vetë për vetë faktin e draftimit të tij.

Strategjia është një dokument përmbajtësor. Në të, shihet qartë traseja zhvillimore e kapaciteteve planifikuese e strategjizuese të institucioneve të Kosovës. Duke dalluar nga strategjitë e mëhershme të energjisë, kjo strategji është më e kompletuar, si për kah aspektet rregulluese, ashtu edhe për kah përmbajtja. Megjithatë, në këtë analizë të shkurtër të politikave publike Konsorciumi Kosovar i Orgaizatave të Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID) dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) vënë në pah disa mangësi serioze të dokumentit, të cilat ne rekomandojmë se duhet adresuar në Kuvendin e Kosovës.

Versioni aktual i strategjisë është i bazuar në inercion të ideve të vjetra të cilat plasohen në një kontekst të ri, është i brishtë sa i përket logjikës së ndërlidhjes së objektivave dhe i vobegët për kah kornizimi i operacionalizimit të objektivave që përcakton. Për më shumë, strategjia bazohet në të dhëna të pjesshme, të vjetëruara dhe jokonsistente, që do ta bëjnë zbatimin e saj tejet problematik.

Teksti i strategjisë nuk e arrin kuptimin e një dokumenti të politikave publike që përcakton gjithë zhvillimet me një sektor. Kur ky tekst reduktohet nga zhargoni, pjesët standarde të referencave institucionale e dokumentative, në të mbetet shumë pak kuptim, e lëre më kornizë për veprim, që do të çonte në arritjen e objektivave të përcaktuara.

## 1. Gjetjet e Përgjithshme

Pikë së pari, duhet thënë që përmbajtja e strategjisë nuk e dëshmon orientimin e Kosovës drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Ani pse qysh në fillim të dokumentit thuhet qartë se strategjia “përcakton objektivat themelore të Qeverisë për zhvillimin e sektorit të energjisë duke marrë për bazë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik” një orientim i tij përfundon me vetë këtë fjali, meqë përcaktimi i objektivave nuk është bërë në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Strategjia është e dominuar nga plani i kahmotshëm për ndërtimin e kapaciteteve të reja të linjitit, plan ky i cili është pasuar si i tillë nga dokumenti në dokument. Në anën tjetër janë veprimet që duhet ndërmarrur sa i përket konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm si koncept orientues i zhvillimit të politikave, ku zhvillimi duhet kënaqur nevojat reale duke konsideruar qëndrueshmërinë në aspektin shoqëror e mjedisor.

## 1.1. Qasja e gjithandejshme

Drafti aktual i strategjisë tingëllon sikur një përmbledhje e përgjithshme e të gjitha çështjeve dhe elementeve në sektorin e energjisë. Së këtejmi, qasja e dokumentit është tejet e përgjithshme, apo, thënë ndryshe, e gjithandejshme. Kësisoj, strategjia parasheh veprime me kapacitete të tanishme e të reja gjeneruese, qoftë nga linjiti ose burime të ripërtritshme, si dhe veprime në kursime, eficiencë, menaxhim të humbjeve dhe përdorimin e energjisë alternative. Madje, edhe vetë teksti i strategjisë thotë se dokumenti përcakton objektivat e qeverisë për “zhvillimin e sektorit të energjisë duke marrë për bazë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, ruajtjen e mjedisit, furnizimin e sigurt dhe cilësor të konsumatorëve, shfrytëzimin eficient të energjisë, zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese konvencionale dhe të ripërtritëshme, krijimin e tregut konkurrues, zhvillimin e sistemit të gazit natyror dhe krijimin e vendeve të reja të punës që ndërlidhen me sektorin e energjisë” ani pse të gjitha këto elemente në fakt janë objektiva në vete dhe jo veç bazë që duhet marrë parasysh. Kësisoj, strategjia më shumë i ngjan një hulumtimi eksplorues sesa një orientimi strategjik. Prioritetet e Qeverisë përmes kësaj strategjie janë thjesht gjithçka dhe gjithkrah, që kosniderohet dobësi bazike e dokumenteve strategjike.

## 1.2. Ekuacioni jologjik

Duke përsëritur lëshimet e dokumenteve të mëhershme strategjike sa i përket sektorit të energjisë, Strategjia e tanishme ka një gabim logjik në shtrirjen e problemit. Në njërën anë, Strategjia parasheh trajektoren e rritjes së konsumit të energjisë dhe parasheh ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, nga linjiti, në mënyrë që të mbulohet konsumi që është në rritje e sipër. Në anën tjetër, dokumenti pranon humbjet teknike e komerciale, mungesën e eficiencës dhe mungesën e burimeve alternative të energjisë, duke paraparë zhvillim në secilën nga këto aspekte. Megjithatë, në ekuacionin strategjik nuk merret parasysh fakti që investimet në zvogëlimin e humbjeve, eficiencën, kursimet dhe përdorimin e energjisë alternative, do të ndryshonin dukshëm në shifrat e konsumit, gjegjësisht nevojën për energji.

### **Shtetet e tjera llogarisin eficiencën si burim të energjisë**

Hartuesit, sërish, nuk kanë marrë për bazë se veprimi në njërën anë të ekuacionit mund të ndryshoj situatën, pasi që ndryshojnë përmasat dhe parametrat në bazë të të cilave është ndërtuar korniza e nevojave të Kosovës në sektorin e energjisë, dhe, rrjedhimisht, rritet kontestueshmëria e nevojës për ndërtimin e kapaciteteve të reja me bazë linjiti. Qysh nga viti 2012, Qeveria e Kosovës ka refuzuar të marrë për bazë skenaret e mundshme të energjisë në Kosovë të studiuara nga University of California Berkeley që e thonë të njëjtën gjë. Thënë troç, me investimet në eficiencë, kursim, burime alternative dhe projekte përkrahëse si ai i infrastrukturës së gasit, nuk mund të dëshmohet nevoja për kapacitete të reja gjeneruese. Dhe kjo ende pa vendosur në ekuacion ndryshimet në dimensionin ekonomik, ku kostoja e prodhimit nga linjiti është rritur, tregu është liberalizuar, dimension ky që e bën edhe më të paqëndrueshëm organizimin e gjithë politikës së energjisë rreth një projekti për gjenerim të energjisë nga linjiti.

### 1.3. Obsesionimi me linjit

Strategjia aktuale, në përmbajtje, më shumë jep përshtypjen të jetë e ndëruar rreth një inercioni prej ideje që ka për bazë ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga linjiti, dhe që, për ta arsyetuar këtë ide, prekë shkarazi disa nga elementet e konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. Esencialisht, veç vëmendja e tekstit shpërndahet tek kursimi, eficientia, burimet e ripërtëritshme dhe punësimi, kurse përmbajtja e strategjisë është e përqendruar në projektin e ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese nga linjiti, e cila arsyetohet me çdo kusht.

Projekti për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re vazhdon të dominojë në politikën e Kosovës për energji. Fakteqësisht, as në këtë draft të strategjisë, Qeveria nuk ka bërë një rillogaritje të efikasitetit real të kostos për një projekt të tillë. Për shembull, Qeveria nuk merr për bazë që me hyrjen në fuqi të akteve të reja rregullative si dhe me liberalizimin e tregut të energjisë, kostoja e gjenerimit të energjisë nga linjiti, pavarësisht vetë kostos së lëndës së parë, mund të jetë e njëjtë, nëse jo më e lartë sesa kostoja e importit në të ardhmen.

Pra, qeveria vazhdon ta trajtojë Kosovën si një univers në vete, të palidhur dhe të palidhshëm me rajonin dhe më gjerë, duke u obsesionuar pas idesë që të kemi kapacitete vetanake gjeneruese, deri në masën që bën gjithçka për të arsyetuar këtë ide.

Është shumë shqetësues fakti se edhe disa obligime të qarta ligjore, siç është çështja e dekomisionimit të termocentralit 'Kosova A', lidhet drejtpërdrejt, tekstualisht, me ndërtimin e termocentralit 'Kosova e Re'. Pa marrë parasysh vetë nevojën e kontestueshme për kapacitete të reja gjeneruese, problemet e rrënjësore të projektit, por as vetë kohën që duhet për t'u jetësuar një projekt i tillë, ndërlidhja e dekomisionimit të njërit termocentral me ndërtimin e tjetrit është lëshim strategjik i cili po u kushton qytetarëve të Kosovës tash e një dekadë.

**Në bazë të legjislacionit evropian, deri në vitin 2050, energjia e prodhuar në BE, do të jetë e dekarbonizuar deri në masën 100%.**

E fundit, qeveria vazhdon të injorojë kostot anësore, shtesë, që janë të pashmangshme kur kemi të bëjmë me gjenerimin e energjisë nga linjiti, gjë për të cilën

vazhdimisht është kritikuar nga organizatat e shoqërisë civile.

**Në kostot e përgjithshme të prodhimit të energjisë elektrike, Qeveria nuk ka marrë për bazë kostot mjedisore dhe shëndetësore për të përlogaritur koston e vërtetë të varësisë së sistemit energjetik në linjit.**

### 1.4. Zbatueshmëria e paplanifikuar

Pjesa më e mangët përmbajtësore në Strategjinë e Energjisë është pjesa e zbatueshmërisë, koston dhe operacionalizimit të mekanizmave politik që ajo parasheh. E gjithë zbatueshmëria e strategjisë përmbledhet në dy faqe, me tabela, ku llogaritet, në vija të trasha, kostoja e përgjithshme në shumë prej 3 miliardë eurosh. Në këtë parashikim të koston mungojnë detajet dhe sqarimet e përlogaritjeve. Së këtejmi, kjo pjesë e dokumentit nuk plotëson as kushtet minimale për t'u konsideruar si plan operacional i zbatueshmërisë së saj.

Strategjia në vete nuk përmban kurrfarë analize të rreziqeve sa i përket zbatueshmërisë së saj. Në fakt, e vetmja analizë në këtë dokument, analiza SWOT, nuk i bëhet strategjisë si dokument qendror i politikave të energjisë, por i bëhet sektorit të energjisë në përgjithësi. Kjo SWOT analizë, pos kornizimit të gabuar, është po ashtu e gjerë, me të dhëna të rrumbullakësuar dhe pa detaje.

E fundit, dhe mbase më e rëndësishmja, *strategjia si tërësi nuk merr për bazë arsyeshmërinë e çmimeve të energjisë dhe së këtejmi nuk vë në fokus qytetarët dhe mundësitë e tyre për qasje në energji.*

## 2. Objektivat joproporcionale

Strategjia ka gjithsejt pesë objektiva, të cilat nuk janë të vendosura as për kah rëndësia, as për kah prioriteti, e as për kah përmbajtja e tyre substanciale. Në fakt, përmbajtësisht ka një disproporcion të theksuar mes objektivave.

### 2.1. Linjiti dhe problemet e heshtura

Objektiva e parë ka të bëjë me zhvillimin e kapaciteteve të reja të linjtit, dhe, esencialisht, është e vetmja që plotëson kriteret primare për të qenë objektiv. Veç sa i përkret ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese Qeveria ka dhënë plan voluminoz të veprimit dhe ndërveprimit. Përkundër vëllimit, plani megjithatë mbetet i mangët për kah të dhënat dhe llogaritjet.




Figura 1. Kostoja shtesë e prodhimit me linjit. Burimi: BWE

Në një llogaritje të bërë nga Asociacioni Gjerman i Energjisë së Erës, për 10.2 c/kWh është më e lartë kostoja reale e djegies së linjtit për prodhim të energjisë elektrike. Në Strategjinë e Energjisë, mungon një analizë e tillë e kostove mjedisore dhe shëndetësore me teknologjinë aktuale të

prodhimit, dhe me koston mjedisore e shëndetësore që do ta shtoj prodhimi i energjisë nga termocentrali i ri nëse i njëjti hyn në funksion.

Në strategji ende mungojnë të dhënat sa i përket teknologjisë së zbatuar, duke iu referuar shkarazi standardeve evropiane, mungojnë kostot e qarta financiare si dhe të dhënat për ndikimet negative në mjedis e shoqëri si dhe menaxhimin e tyre. Për shembull, Qeveria ende vazhdon të mos e llogarisë në ekuacionin e përgjithshëm koston e efekteve anësore të kapaciteteve të reja nga linjiti, siç është çështja problematike e zhvendosjes së banorëve për shkak të zgjerimit të mihjeve. Kjo objektivë, fatkeqësisht, mbetet më pak e zhvilluar sa i përket aspektit të implementimit sesa që është prezantuar përgjatë dekadës së fundit prej kur ideja për kapacitete të reja nga linjiti është duke u diskutuar.

## 2.2. Integrimi në treg

Si objektivë të dytë, Qeveria ka vendosur integrimin në tregun rajonal të energjisë dhe ka paraparë krijimin e një zone të vetme tregtare mes Kosovës dhe Shqipërisë. Përderisa integrimi në treg nuk është zgjedhje por më shumë si obligim i Kosovës, duhet theksuar se kjo objektivë bie ndesh,

**“Planifikimi i ndërtimit të kapaciteteve të reja nuk duhet bërë duke marrë parasysh situatën e tanishme, por atë të një tregu të integruar! Kushtet në të cilat po planifikohet termocentrali dhe ato të cilat do të jenë në të ardhmen e afërt janë shumë të ndryshme!”** – Janez Kopac – Drejtor i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Fjalë e dhënë para Komisionit parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri me datë 24.01.2017

kryekëput, me gjithë përlllogaritjet në objektivën e parë, konkretisht me përlllogaritjet e nevojës për kapacitete të reja gjeneruese. Po ashtu, integrimi i tregut nuk elaborohet në kuptimin e përparësive, mangësive si dhe rreziqeve që mund t'i ketë. Tëni normativ i dokumentit i referohet tërësisht standardeve evropiane dhe nuk buron nga arsyeshmëria vendore, sidomos sa i përket integritit të tregut. Po ashtu, asnjë nga ndryshimet që një integrim i tillë do të sjellte në situatën e energjisë në Kosovë nuk është marrë parasysh. E gjithë puna e paraparë në këtë objektivë kufizohet në plotësimin dhe ndryshimin e legjislacionit në mënyrë që

formalisht të arrihet objektiva. Megjithatë, nuk ka kurrfarë elaborimi për efektet e një zhvillimi të tillë, qoftë për sektorin privat, qoftë për qytetarët.

## 2.3. Termika

Për dallim prej strategjive të kaluara dhe dokumenteve tjera strategjike sa i përket fushës së energjisë, duhet vlerësuar progresin sa i përket mosreduktimit të konceptit të energjisë në energjinë elektrike. Ani pse shumica e strategjisë në fakt flet për energjinë elektrike, parashikimi i zhvillimeve në fushën e energjisë termike është i mirëseardhur në parim. Megjithatë, si objektivë, termika mbetet tërësisht në nivel të planifikimeve në letër, pa projekte konkrete dhe sidomos pa detaje të konkretizimit të projekteve të tilla. Strategjia parashihet zgjerim të rrjetit termik në Prishtinë dhe Gjakovë si dhe disa studime për fizibilitet të ndërtimit të rrjeteve të ngjashme në zonat tjera urbane të Kosovës. Megjithatë, nuk përcakton një target konkret, në nivel nacional, sa i përket energjisë

termike dhe së këtejmi është tejet e mangët si objektivë. Ani pse strategjia përmend shfrytëzimin e energjisë së humbur termike nga proceset teknologjike, nuk përmban kurrfarë plani të veprimit sa i përket kësaj pike. Po ashtu, vlen të theksohet se kjo objektivë është tejet joproporcionale me dy objektivat e para në kuptimin e punëve që janë paraparë të bëhen drejt saj.

## **2.4. Gasi**

Diversifikimi i burimeve të energjisë nuk është veç trend por edhe domosdoshmëri dhe kësisoj edhe prioritet për Kosovën. Së këtejmi, është për t'u vlerësuar fakti që Qeveria ka paraparë një nga objektivat e strategjisë të jetë zhvillimi i infrastrukturës së gasit natyror. Megjithatë, si objektivë e strategjisë, infrastruktura e gasit përfshin veç fazën përgatitore, dhe atë, pa ndonjë cak të përcaktuar paraprakisht. Kësisoj, në dhjetë vjetët e ardhshme, Kosova pritet veç të ngrisë kapacitete institucionale për gasin natyror dhe të përgatisë një master plan për procesin e gasifikimit. Për asnjërin nga këto pika të objektivës nuk parashihet as kosto e detajizuar, as plan veprimi, e as caqe konkrete.

## **2.5. Objektiva e zhvillimit të qëndrueshëm**

Treguesi më i mirë se Kosova nuk e ka zgjedhur qasjen e zhvillimit të qëndrueshëm gjatë përpilimit të Strategjisë së Energjisë është objektiva e pestë e kësaj strategjie, në të cilën brutalisht vendosen të gjitha çështjet e efijencës së energjisë (EE), burimeve të ripërtrishme të energjisë (BRE) si dhe mjedisit. Ani pse secila prej tyre patjetër se ka qenë dashur të jetë objektivë në vete, Qeveria i ka përmbledhur që të gjitha nën objektivën e pestë dhe të fundit të strategjisë, që apriori tregon mosprioritetizimin e këtyre tri çështjeve kyçe. Përkundër kësaj përmbledhjeje, megjithatë, secila pikë në këtë objektivë është më shumë e zhvilluar në vete, dhe, përmban më shumë detaje, sesa objektivat 2, 3 dhe 4. Kësisoj, përfundimisht, shihet se objektivat në strategji janë vendosur në mënyrë joproporcionale dhe pa respektimin e kriterëve a prioriteteve, si dhe pa marrë për bazë substancën e tyre.

Problemi i dytë me objektivën e pestë, atë që përfshin komponentet e zhvillimit të qëndrueshëm, është fakti se Qeveria si objektivë ka përcaktuar veç plotësimin e caqeve dhe detyrimeve që vijnë si rezultat i përkushtimeve ndërkombëtare që ka bërë Kosova. Pra, shihet qartë, se EE, BRE dhe mjedisi nuk janë prioritet i brendshëm për qeverinë, nuk burojnë nga orientimi i brendshëm për një politikë të tillë, por më shumë llogariten si obligime të jashtme. Nga e kaluara, e dimë se kjo qasje rezulton, në rastin më të mirë, në plotësimin pro-forma të kushteve, kriterëve dhe caqeve të parapara, dhe në rastin më të keq, me stagnim.

Qeveria nuk ka përcaktuar caqe të veta sa i përket EE e as BRE por ato i ka më tepër të detyruara nga jashtë. Një përcaktim i tillë, i përshkallëzuar, i caqeve vendore, do të ishte mënyra më e mirë për të ndërtuar një strategji kaq të rëndësishme politike.

Është për keqardhje, se për të pestin vit me radhë, qeveria ende planifikon themelimin e një 'one stop shop' për BRE, dhe që i njëjti plan, përkundër faktit që mund të realizohet brenda një periudhe shumë të shkurtë dhe pa kosto të lartë, zë vend në strategjinë për dekadën e ardhshme. Vetëm tani, Qeveria ka hartuar një Udhëzim Administrativ për One Stop Shop, që parasheh atë në formën e



një qendre informimi e jo të një vendi ku realisht investitorët do të asistoheshin në kryerjen e procedurave dhe do të shërbente si një sportel i vetëm për kompletimin e dokumenteve.

Është totalisht absurde që pjesa e mjedisit në objektiven e pestë të strategjisë së energjisë të përqendrohet vetëm në përmbushjen e disa obligimeve për të cilat Kosova veçse është vonuar, siç është dekomisionimi i TC ‘Kosova A’. Për më shumë, të gjitha masat që parashihen sa i përket pjesës mjedisore të objektives së pestë, janë masa që burojnë nga obligimet ndërkombëtare, gjegjësisht Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE) dhe Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA). Në tekst të strategjisë mungon çfarëdo integrimi i politikave mjedisore të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në të.

### 3. Strategji e Energjisë pa planifikuar naftën

Në këtë Strategji të Energjisë, nuk është shtjelluar aspak nafta dhe furnizimi i Kosovës me derivate.

Kosova ende nuk e ka të rregulluar çështjen e rezervave të detyrueshme të naftës. Siguria e furnizimit nënkupton ndër të tjera edhe furnizimin me naftë. Për më tepër, nuk është paraqitur ndonjë analizë e promovimit të politikave në fushën e transportit që do të promovonin transformimin e karburantit nga ai fosil në elektrik dhe/ose hibrid. Nuk janë paraparë masa, targete dhe rezultate të pritura në fushën e promovimit të prodhimit të biodizellit dhe komponentëve të tjerë që kanë ndotje më të ultë. Nuk është bërë përllogaritje e ndotjes nga transporti aktualisht dhe një projeksion për vitet e ardhshme.

**“Kosova as nuk prodhon as nuk rafinon naftë. Në vitin 2014, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka hartuar një Ligj për Rezervat e Detyrueshme të Naftës me asistencën e Sekretariatit. Ligji është paraparë të hyj në fuqi në qerekun e fundit të vitit 2016 ose në fillim të 2017 por aprovimi nga Qeveria dhe Kuvendi ka dështuar. Kosova duhet të draftoj një plan urgjent të adresimit të rezervave 90/61 ditë rezerva.” – Raport i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë**




Figura 2. Implementimi i legjislacionit nga palët nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë: Burimi: Sekretariati i Komunitetit të Energjisë

Siç sugjeron figura e mësipërme, Kosova nuk ka përmbushur legjislacionin dhe objektivat në fushën e naftës dhe produkteve të saj. Mospërfshirja meritore e saj në këtë strategji, tregon se ende mungon vullneti për ta prioritetizuar transformimin e sektorit dhe rritjen e sigurisë së furnizimit.

## 4. Gjetjet tjera

Pos problemeve të identifikuar më lartë, e që janë probleme përmbajtësore, në kuptimin e asaj që parashihet në strategji, por edhe strukturore, sa i përket mënyrës se si kjo strategji do të mund të jetësohet përmes ciklit të politikëbërjes në Kosovë, KOSID dhe INDEP ka identifikuar edhe një sërë problemesh specifike. Ani pse këto probleme kanë peshë më të vogël sa i përket kualitetit të strategjisë si të tillë, shumë prej tyre vënë në pah mungesën e profesionalizmit dhe përkushtimit të hartuesve të strategjisë.

Tek pjesa e strategjisë që flet për sfidat dhe problemet me sektorin e energjisë në Kosovë, teksti përmban një përsëritje të narrativit të promovuar nga qeveritë e kaluara, pa analizë të duhur dhe pa përfshirje të detajeve të rëndësishme, që do t'i jepnin strategjisë një pamje më të mirë analitike përpara se të ndërtohet qasja intervenuese në këtë sektor.

Në fakt, e vetmja analizë e strukturuar dhe metodologjike në gjithë dokumentin është një SWOT analizë, e cila nuk i bëhet strategjisë si dokument qenësor i politikave publike, por i bëhet sektorit të energjisë në Kosovë. Kështu, SWOT analiza në fakt del një përsëritje e narrativeve energjetike për Kosovën.

Vërejtja e fundit për këtë rishikim, por jo më pak e rëndësishme, strategjia thekson rëndësinë e saj për sigurinë kombëtare, qysh në fillim të dokumentit, duke e arsyetuar kështu rëndësinë e saj si dokument strategjik. Megjithatë, nuk ka asnjë të vetmen referencë për këtë ndërlidhje. Jo vetëm që nuk arsyetohet ndërlidhja me sigurinë kombëtare, as në rrafshin konceptual, as në atë praktik, por madje as që e përmend atë. Koncepti i sigurisë kombëtare kontrabandohet për të shërbyer si faktor i rëndësishëm, duke krijuar kështu ngarkesa e presione diskursive, dhe së këtejmi ose duhet adresuar mirë, ose duhet hequr nga teksti i dokumentit.

## Përfundime

Draftit të Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës 2017-2026 nuk i mungon diskutimi i përgjithshëm por i mungon orientimi strategjik siç do të duhej të ishte gjuha e një dokumenti të tillë. Në dokument të gjitha janë paraqitur si prioritet dhe për të gjitha është argumentuar se Qeveria do të marrë masa, por nuk ekziston një çasje e fokusuar e zhvillimit të sektorit, që qartësisht do t'i jepte prioritet një sektori ose disa sektorëve në krahasim me të tjerët.

Strategjia në njërin anë llogaritë kërkesën për energji bazuar në shifrat e tanishme të konsumit, e në anën tjetër pranon nevojën për investime dhe masa në zvogëlim të humbjeve dhe kursim të energjisë. Eficienca e energjisë ende nuk trajtohet si një nga burimet e rëndësishme të energjisë për të ardhmen, por vetëm si cak i domosdoshëm i imponuar nga jashtë.

Qeveria nuk ka bërë një rillogaritje të efikasitetit real të kostos për projektin Kosova e Re. Ekziston një përqendrim deri në obsesion për linjit por nuk është përlllogaritur kostoja reale e përdorimit të tij për prodhim të energjisë. Shtete të tjera, si p.sh. Gjermania, kanë llogaritur koston shtesë që sjellë përdorimi i linjtit. Është llogaritur se kostoja mjedisore dhe shëndetësore është edhe për 10.2 euro cent për kilovat nëse linjiti është baza e prodhimit të energjisë. Marrë në konsideratë faktin

që kjo strategji në masë të madhe fokusohet në këtë teknologji, një analizë e tillë do të ishte e domosdoshme.

Strategjisë i mungon një analizë e zbatueshmërisë në përgjithësi. Në strategjitë e vendeve të tjera, i është dhënë një rëndësi e madhe rezultateve të pritura. Në këtë strategji, përkundrazi, nuk është bërë as një SWOT analizë e mirëfillt e kostove, rezultateve të pritura dhe përfitimeve nga politikat e ndërmarra. Kësisoj, edhe njëherë, dokumenti është më tepër i fokusuar në prioritetet e përgjithshme sesa që është i bazuar në shifra e rezultate të matshme. Strategjia gjithashtu nuk merr për bazë trendet afatgjata, të tilla si politika evropiane e dekarbonizimit e cila deri në vitin 2050 parasheh sisteme energjetike evropiane të liruara plotësisht nga djegiet fosile.

Nuk ka një analizë të çmimit të energjisë dhe përballueshmërisë së tij nëpër skenarë të ndryshëm. Kjo do të ishte e domosdoshme për të parashikuar koston sociale të prodhimit të energjisë dhe çmimeve. Nuk është bërë ndarje e çartë në mes të derregullimit të çmimeve të energjisë dhe mbulimit të koston së ndërtimit të kapaciteteve të reja energjetike. Kostoja sociale është dashur gjithësesi të parashihet në një trajektore për shkak se ka shqetësime të vazhdueshme për impaktin e termocentralit të ri në çmimin e energjisë tek konsumatorët fundorë.

Një strategji e energjisë që nuk parashikon kaptinë të veçantë për naftën dhe nuk e trajton atë sa duhet nuk mund të quhet strategji e plotë. Furnizimi me naftë, e veçanërisht rezervat e naftës janë pothuaj krejtësisht të munguara. Kosova aktualisht llogaritet të ketë rezerva të naftës për vetëm katër ditë të konsumit, ndërkohë që legjislacioni evropian kërkon që të ketë rezerva sa mesatarja e së paku 61 ditëve të importit ose e 90 ditëve të konsumit. Niveli aktual i rezervave të naftës nuk garanton siguri të furnizimit dhe kjo është dashur të paraqitet në raport. Gjithashtu, politikat e transportit përfshirë transformimin e karburantit dhe mbrojtjen e mjedisit e të shëndetit nuk janë trajtuar në strategji.

Integrimi i tregjeve të energjisë dhe në veçanti i tregut të energjisë elektrike nuk është elaboruar sa duhet. Një dokument strategjik i tillë do të duhej të elaboronte koston e një procesi të tillë, benefitet dhe ndikimet tek akterët në treg, tek rrjeti i tanishëm dhe veçanërisht tek qytetarët. Integrimi i tregut dhe derregullimi i çmimeve do të duhej të kishin ndikim përfundimtar në politikat energjetike në vend, por në bazë të strategjisë këto përmenden si objektiva nga këndi i obligimeve ndërkombëtare por nuk jepen shpjegime dhe analiza mbi kost-benefitin e tyre pasi ato të ndodhin.

Përfundimisht, strategjia edhe me rastin e integritit të tregut të energjisë, edhe në përcaktimin e prioriteteve në fushën e energjisë, vërehet që nuk janë analizuar skenarë të ndryshëm dhe nuk janë dhënë shifra që balancojnë integritin dhe derregullimin e çmimeve me nevojën ose jo për kapacitete të reja. Strategjia ka nevojë të plotësohet me prioritete të qarta, që merr në konsideratë të gjitha koston dhe skenarët dhe që i jep Kosovës një drejtim të qartë e konsensual të zhvillimit të sektorit të energjisë.

Shtojcë 1

Hulumtim krahasues i strategjive të shteteve të tjera

	Kosova	Austria	Maqedonia	Cekia	Bullgaria	Kroacia	Hungaria	Italia	Moldavia
Janë hartuar rezultatet e pritura për secilën fushë	JO	PO	PO, si dhe rezultate për skenarë të ndryshëm	JO për secilën pjesë	PO	Po	JO për secilën pjesë	PO	PO
Nafta është pjesë e veçantë Strategjisë	JO	PO, si dhe për zëvendësimin me karburante më pak ndotëse	PO	PO	PO	PO	PO	PO	JO
Transporti është pjesë e veçantë e Strategjisë	JO	PO	PO	PO	JO	PO	PO	PO	JO
Punësimi është llogaritur	JO	PO	PO	PO	E paraparë, jo e llogaritur	E paraparë, jo e llogaritur	PO	PO	JO
Indikatorët ekonomik janë marrë parasysh	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO
Indikatorët demografik janë marrë parasysh	JO	JO	JO	PO	PO	JO	PO në kapitull të veçantë	JO	PO

Kostoja mjedisore është	JO	PO	PO	PO	JO	PO	JO	PO	JO
Kostoja shëndetësore është marrë parasysh	JO	PO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO